



Lushnja e tifozëve të shumtë ka barazuar me Vllazninë në Roza Haxhiu pa mundur të marrë tre piket që lagunaret do të kishin dashur. Shkodranët, si një skuadër simpatike kanë ditur të luajnë futboll të bukur në Lushnjë dhe i kanë vënë në veshtirësi vendasit. Golin e parë të takimit e shënuan kuqëblutë e kanë realizuar shkodranët falë mesfushorit Alsid Tafilit. Lushnja nuk e ka pranuar disavantazhin dhe duke u hedhur menjëherë në sulm ka gjetur barazimin me anë të bomberit vendas Mirel Canka. Me pas, ndeshja është luftuar shumë në mesfushë dhe të dy ekipet kanë pasur rastet e tyre për shenim. Vllaznia e ka bërë dy here dicka të tilla por për gjyqtarin kanë qenë të parregullt. Megjithatë, për mënyrën se si shkuan minutat, të dy ekipet janë ndarë në paqe dhe të kënaqura me pikën e marrë nga ky takim.